

AUTONOMIA

VENDORE

PUBLIKIM I SHOQATËS PËR AUTONOMINË VENDORE | QERSHOR 2022 NUMRI 6

KRYEARTIKULL

TIRANA KRYEQYTETI EVROPIAN I TË RINJVE 2022

Gjatë këtij viti janë planifikuar të zhvillohen rreth 1000 aktivitete...

VIJON NE FAGEN 2



EDITORIAL

RENTA MINERARE

Proceset reformuese të ndërmarra vitet e fundit për pushtetin vendor kanë sjellë ndikimin e tyre pozitiv në buxhetin e bashkive, veçanërisht me Ligjin 68/2017 të financave vendore. E megjithatë dhe ky ligj nuk solli



përfitime të rritura për bashki me pasuri të mëdha nëntokësore në territorin e tyre.

Një pjesë e mirë e bashkive në Shqipëri zotërojnë në territorin e tyre pasuri të mëdha natyrore, por gjithsesi këto bashki renditen mes bashkive me nivel të lartë varfërie, pavarësisht pasurive natyrore të tyre.

VIJON NE FAGEN 4

PROJEKTE DHE AKTIVITETE

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR: Kongresi i Autoriteteve Lokale

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Komisionit Evropian miratoi Raportin e Komitetit të Monitorimit për Shqipërinë.

10



PROJEKTE DHE AKTIVITETE

BE për Bashkitë

“BE për Bashkitë” është një projekt që ka prioritet mbështetjen e proceseve strategjike, të cilat do t’iu mundësojnë aktorëve të qeverisjes lokale të mobilizojnë burimet për të zbatuar planet dhe strategjitë e tyre.

13



SHTYLLAT KRYESORE



AUTONOMIA VENDORE



DECENTRALIZIMI



DEMOKRACIA LOKALE



RRITJA E KAPACITETEVE



EDUKIMI DHE SPORTI



MJEDISI

Përmbajtja

QERSHOR 2022 NUMRI 6

#Renta4
Bashkitë
R4B

04 EDITORIAL

• Renta Minerare

06. PROJEKTE DHE AKTIVITETE

- Komuniteti Lokal
- Shërbimet Publike
- Shërbimi Social
- Financat Vendore
- Arsimi Parashkollor
- Workshope dhe Trajtime
- Bashkëpunimi Ndërkombëtar
- Turizmi dhe Kultura
- Projekti SoRi II
- BE për Bashkitë

14. PUBLIKIME

- Raporti i Rentës
- Raporti i Performances se Bashkive

**SHOQATA
PËR AUTONOMINË
VENDORE**

Adresa

Rruga Reshit Çollaku,
Pallati 38 shkalla 2 ap. 13/1,
Tiranë, Shqipëri

Email: info@shav.al

TIRANA KRYEQYTETI EVROPIAN I TË RINJVE 2022



Ishte viti 2018 kur pas një reflektimi disa mujor dhe takimeve planifikuese, Kongresi Rinor Kombëtar vendosi t'i drejtohet Bashkisë Tiranë si institucion përgjegjës i qeverisjes lokale të Tiranës për të ndërtuar një urë bashkëpunimi, dhe për të nisur një rrugëtim impenjativ e me rëndësi për rininë shqiptare, aplikimin për të qenë kandidat për titullin "Kryeqyteti Evropian i Rinisë"

Pas një rrugëtimi që zgjati më shumë se një vit, grupi i punës së Kongresit Rinor Kombëtar, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, arriti të ndërtojë një projekt-program të plotë dhe tejet ambicioz, i cili u vlerësua nga juria e EYF si aplikimi fitues, duke bërë që Tiranës t'i atribuohet titulli e të kthehet në Kryeqytetin Evropian të Rinisë për vitin 2022.

Puna e përbashkët e Kongresit Rinor Kombëtar dhe Bashkisë Tiranë u vlerësua për fokusin tek të rinjtë dhe programin që synon të sjellë një perspektivë rinore në të gjithë aspektet e jetës së qytetit, por jo vetëm, vibrimi i Tiranës si qytet me përfaqësi rinore nga i gjithë vendi e zgjeron rrjedhimisht përkatësinë e këtij titulli dhe i jep një karakter kombëtar.

Tirana u shpall "Kryeqyteti Evropian i Rinisë" në 2019, në Amiens, Francë, dhe stafetën zyrtare të këtij titulli e mori më 17 Dhjetor 2021 në Klaipeda, Lituani, përgjatë ceremonisë përmbyllëse të "Klaipeda - Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2021".

"Ne do të kemi vitin tjetër edhe Dua Lipën edhe Rita Orën, e në qoftë se ka sugjerime të tjera, jeni të mirëpritur të na i thoni. Do ishte gabim nëse ky do të trajtohej si një vit feste dhe ahengu sepse nuk është vetëm i tillë. Ne duam edhe të reflektojmë, të krijojmë lidhje, të krijojmë projekte që do t'i vazhdojmë përtej vitit 2022, të cilat mund të kthehen në marrëdhënie afatgjata", pohoi Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj asaj kohe.

Tirana EYC 2022 paraqitet si një makro program dhe mundësi fantastike që është duke vijuar aktivitetin e tij përgjatë 365 ditët e këtij viti, gjatë të cilave është vënë në jetë kalendari i projekteve me iniciativa e aktivitete të shumta, të cilat po mbulojnë një gamë të gjerë tematikash e prioriteteve që kanë në qendër rininë, në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian.



Gjatë këtij viti janë planifikuar të zhvillohen rreth 1000 aktivitete të cilat kanë nisur të implementohen duke startuar prej janarit përgjatë dymbëdhjetë muajve të vitit, me kryefjalë Të Rinjtë e Tiranës, Rajonit dhe Evropës.

Ky program synon të fuqizojë rininë duke krijuar mundësi të reja e duke i dhënë asaj një dimension evropian. Ndër të tjera, programi synon:

- të sjellë ndryshime pozitive;
- të inkurajojë pjesëmarrjen aktive;
- të promovojë dhe të mbrojë

diversitetin dhe gjithëpërfshirjen;

- të rrisë investimet për të rinjtë;
- të transformojë qytetin në një pikë ndërkombëtare takimi;
- të krijojë rrjetëzime dhe sinergji mes të rinjve nga e gjithë Evropa.

Shoqata për Autonomi Vendore i është bashkuar kësaj nisme madhore të kryeqytetit me javën e saj të bashkive rinore e cila do të kulmojë me një event madhor në vjeshtën e 2022. Ky event synon të mbledhë të gjithë Këshillat Rinor Lokal dhe komunitetin e sipërmarrësve të rinj nga çdo bashki e vendit në Tiranë

me qëllim ndarjen e përvojave dhe teknikave të suksesit nga sipërmarrësit novator me të rinjtë ambicioz.

Gjatë vitit 2022 janë bërë disa thirrje të hapur për përfshirjen e të rinjve dhe ideve rinore në aktivitetet që do të zhvillohen me të rinjtë, për të rinjtë, nga të rinjtë.

Nëse ju jeni një i ri apo e re nga 18-30 vjeç, jetoni në Tiranë dhe keni dëshirë të bëheni pjesë e këtij programi vjetor, atëherë ju ftojme të aplikoni pa humbur kohë për të qenë një nga anëtarët e Skuadrës së Aktivistëve të Tirana EYC 2022. Skuadra e Aktivistëve do të jetë një skuadër e madhe, dhe ti mund të jesh pjesë e saj!

Për më shumë informacion rreth këtij evenimenti vjetor dhe mundësi për tu bërë pjesë e tij ju ftojme të navigoni në faqen zyrtare të internetit: <https://tiranaeyc2022.al/>

EDITORIAL

RENTA MINERARE



VIJON NGA FQAJE 1

25% e bashkive zotërojnë në territorin e tyre pasuri të mëdha natyrore, ndërkohë që në to operojnë 40 - 48% e licensave aktive. Këto bashki sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2018 renditen mes bashkive me nivel të lartë varfërie, pavarësisht pasurive natyrore të tyre.

Bashkitë kanë adresuar vazhdimisht tek Shoqatat, kërkesa për të rritur nivelin e rentës për bashkitë mbi 5%, si dhe thjeshtimin e mekanizmave deri tani burokratikë të cilat kanë çuar në mospërthithjen as të 5% të garantuar nga ligji.



#Renta4 Bashkitë R4B

Për këtë arsye, Shoqata për Autonomi Vendore (SHAV) dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë (SHBSH) kanë bashkuar përpjekjet e tyre lobuese për të sjellë ndryshim të përqindjes së rentës në favor të bashkive dhe në funksion të rritjes së standardit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Për një periudhë 9 mujore, të dy Shoqatat u angazhuan në zbatimin e projektit "Renta4Bashkitë-R4B", i cili u implementua në 30 bashki të vendit përmes zhvillimit të një fushate advokimi për të kryer ndryshimet e nevojshme sipas kërkesave dhe nevojave lokale.

Projekti "Renta4Bashkitë-R4B" synon rritjen e kapaciteteve të nevojshme të burimeve njerëzore të këtyre bashkive

në funksion të rritjes së kapaciteteve vlerësuese të bashkive, njohuritë e tyre mbi mënyrën dhe ndjekjen e procedurave për marrjen e rentës, njohjen e kuadrit ligjor, etj.

ShAV dhe ShBSH vazhdojnë të punojnë me të gjithë aktorët teknikë dhe janë duke lobuar në mënyrë permanente me aktorët politikë për të rritur ndërgjegjësimin e tyre në funksion të objektivit për ndryshime ligjore me qëllim rritjen e nivelit të rentës sipas tre opsioneve, ku renta në favor të bashkive të arrijë të paktën dyfishimin e saj.

Projekti mëton të kontribuojë në forcimin e autonomisë fiskale dhe financiare të Njësisë të Qeverisjes Vendore si element i rëndësishëm i decentralizimit dhe forcimit të demokracisë vendore në Shqipëri.

Ky projekt vjen në kuadër të projektit 'Dialog për zhvillim politikash gjithëpërfshirëse në Shqipëri (ideAL)' implementuar nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në bashkëpunim me European Policy Center (Bruksel) dhe me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.

Si pasojë e adresimit të kërkesave

të vazhdueshme të bashkive tek Shoqatat, për të rritur nivelin e rentës për bashkitë mbi 5%, dhe thjeshtimin e mekanizmave për përthithjen e 5% të garantuar nga ligji, Shoqata për Autonomi Vendore në bashkëpunim me Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë dhe me mbështetjen e bashkive në vend ka organizuar gjatë muajit Maj ciklin e takimeve dhe trajnimeve në Tryeza Rajonale në bashkitë Bulqizë, Roskovec dhe Dimal për rritjen potenciale të rentës në kuadër të projektit "Renta4Bashkitë-R4B".

Gjatë takimeve dhe trajnimeve aktorët teknik të pushtetit vendor u prezantuan me ndryshimet e mundshme ligjore në kuadrin e ligjeve të rëndësishme, si ai i taksave kombëtare dhe ai i financave vendore.

Me kryebashkiakët u diskutua mbi mundësitë që projekti "Renta4Bashkitë-R4B" krijon për nevojat e komunitetit të njësisë vendore duke theksuar meritën e bashkive për më shumë të ardhura prej rentës në raport me përfitimet që ato i japin vendit.

Projekte dhe Aktivitete

KOMUNITETI LOKAL



Shoqata për Autonomi Vendore në bashkëpunim me bashkitë ka në fokus përmirësimin e kushteve të komuniteteve lokale. Këtë herë u ndalëm në qytetin e Durrësit, ku me bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me kryetaren Emiriana Sako, inaguroam Këndin e Lojrave si një ambient pushues dhe argëtues, në shërbim të fëmijëve dhe komunitetit të zonës.

“Ne si Shoqatë po zbatojmë disa projekte zhvillimore të cilat synojnë t’i vijnë në ndihmë komuniteteve vendore përmes ofrimit të infrastrukturës të munguar. Kënaqësi që bashkë me kryebashkiaken Sako inagurojmë këtë kënd lojrash që vjen si rezultat i bashkëpunimit me NALAS dhe GIZ Albania për më shumë mbështetje për komunitetin” - u shpreh Drejtoresha e SHAV, Adelina Farrici, gjatë inagurimit të këndit të lojrave në një prej lagjeve të njohura të qytetit bregdetar.

Ky projekt realizohet në kuadër të projektit “Përforsim i kapaciteteve lokale për zbatimin e Agjendës 2030” dhe parimit “Askush mos të mbetet pas”, i financuar nga NALAS në bashkëpunim me GIZ mbi “Mbështetja e qeverise lokale në kohën e Covid-19.”



SHËRBIMET PUBLIKE: RAPORTI I PERFORMANCËS SË BASHKIVE

Shoqata për Autonomi Vendore me mbështetjen e projektit Bashki të Forta, dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe ekspertë të fushës kanë ndërmarrë nismën për të realizuar Raportin e Performacës së Shërbimeve Publike të bashkive në vend, përgjatë periudhës së vitit 2020.

Kjo nismë ofron një model raportimi koherent lidhur me përdorimin e fondeve publike nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, duke realizuar në këtë mënyrë një sistem të monitorimit të funksioneve, i cili do të pasurohet vit pas viti.

Raporti i Performacës së Shërbimeve Publike ka në fokus punën e kryer nga bashkitë respektive në sektorë të ndryshëm të ofrimit të shërbimeve publike si ai mbetjeve urbane, pyjet dhe ndriçimi publik, planifikimi urban, zhvillimi ekonomik, kultura, sporti dhe turizmi.



Analiza e të dhënave në këtë raport mëton të nxjerrë në pah tregues, të cilët do të shërbejnë si kriter vlerësimi për funksionimin e pushtetit vendor në Shqipëri, për shpërbimin ndaj qytetarit nëpërmjet menaxhimit saktë të buxhetit.

Përgjatë këtyre muajve, Shoqata për Autonomi Vendore së bashku me aktorët e përfshirë në këtë nismë kanë organizuar takime me bashkitë për prezantimin e rezultateve vlerësuese të raportit, me qëllim ofrimin e një informacioni përfaqësues mbi përdorimin e fondeve publike nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Ndër të tjera, nëpërmjet këtij raporti ofrohet një analizë krahasuese ndërmjet bashkive, e cila shërben si një mekanizëm për identifikimin e mangësive të raportimit nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.



Raportii Performacës së Shërbimeve Publike në nivel vendor jo vetëm që është një instrument matës i domosdoshëm i efikasitetit të çdo bashkie, por dhe nxit diskutimin dhe shkëmbimin e opinionëve dhe rekomandimeve lidhur me raportimin e rradhës të performancës së zbatimit të buxhetit.

Standardet e shërbimeve vendore janë të domosdoshme për raportimin dhe performancën në nivel vendor, por kanë një rëndësi të veçantë edhe në hartimin e politikave në nivel qendror.

Nisma për hartimin e raportit studimor mbi performancën e pushtetit vendor në zbatim të buxhetit për vitin 2020, për programet buxhetore të Njësitë për Vetëqeverisjen Vendore i sjell ato më afër qytetarit, si dhe është një ndihmë për vetë bashkinë, institucionet dhe grupet e interesit.

Projekte dhe Aktivitete

SHËRBIMI SOCIAL

Zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve në qeverisjen vendore dhe fuqizimi i administratës lokale është një prej përpjekjeve kryesore në ecurinë e reformës së administratës publike në nivel vendor.

Prioriteti i Shoqatës për Autonomi Vendore është mbështetja e administratës lokale, për t'iu përgjigjur pritshmërive dhe nevojave të komunitetit për shërbime publike të specializuara, duke përfshirë në këtë proces të gjitha hallkat e burimeve njerëzore, të cilat mbulojnë mbarëvajtjen e çdo sektori të shërbimit ndaj qytetarit.

“Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve (RCDN) për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimeve, është projekti i cili synon përmirësimin dhe specializimin e kapaciteteve dhe njohurive të burimeve njerëzore mbi menaxhimin administrativ dhe teknik të rrjetit të furnizimit me ujë.


Në kuadër të implementimit të këtij projekti, si dhe për t'ju ardhur në ndihmë bashkive përkatëse për përfitimin saktë të njohurive në fushën e menaxhimit me efikasitetet të sektorit të shpërndarjes së ujit dhe kanalizimeve, Shoqata për Autonomi Vendore në bashkëpunim me ekspertë që disponojnë eksperiencën e duhur në këtë fushë ka përgatitur kurrikulën me materialet e nevojshme për trajnim të stafit të punonjësve.

Në këtë kuadër, SHAV në bashkëpunim me Drejtorinë e Ujësjellës Kanalizimeve dhe me bashkitë në vend,

organizuan trajnimin me temë “Zhvillimi i Kompetencave për punonjësit e Njësive të Qeverisjes Vendore për Shërbimet e Ujësjellës Kanalizimeve”.

Nëpërmjet këtij trajnimi dhe asistencë të ekspertëve për ndarjen e njohurive që i shërbejnë rritjes së kapaciteteve të punonjësve të Njësive të Qeverisjes Vendore, burimet njerëzore të administratës lokale dhe shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve do të kenë praktikën e duhur jo vetëm përsa i përket zbatimit dhe përmbushjes së përgjegjësisë ligjore, por mbi të gjitha për ofrimin e shërbimeve cilësore të furnizimit me ujë dhe grumbullimit dhe trajtimit të ujërave.

Përgatitja dhe specializimi i burimeve njerëzore në Bashkitë e vendit është një parakusht i rëndësishëm ndaj përgjigjes së sfidave të integritimit evropian të vendit sikurse dhe thithjes së fondeve të BE-së me fokus zhvillimin e qëndrueshëm përmes adaptimit të reformës territoriale në vend.



FINANCAT VENDORE

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2021, Shoqata për Autonomi Vendore ka zhvilluar një seri takimesh e tryezash publike me grupet e interesit dhe aktorët kryesor të buxhetimit lokal për të ofruar më pas rekomandimet e saj në Komisionet Parlamentare në lidhje me projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2022”.



Kontributi dhe rekomandimet e Shoqatës në hartimin e projekt-ligjit për buxhetin 2022 për qeverisjen vendore, kanë qenë të fokusuar në rritjen e fondeve në drejtim të emergjencave civile, menaxhimit të mbetjeve, rritjes së përqindjes së rentës minerare në favor të bashkive dhe mbështetje për arsimin parashkollor.

Paralelisht SHAV ka asistuar pushtetin vendor me trajnime dhe pjesëmarrje në përgatitjen e “Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024” duke e parë atë si një mundësi e mirë për qeverisjen lokale për të adresuar në kohë dhe siç duhet nevojat e tyre afatmesme të buxhetimit.



ARSIMI PARASHKOLLOR

Arsimi është një tjetër fushë, ku Shoqëria për Autonomi Vendore synon të trajtojë me prioritet të gjitha mundësitë për përmirësimin e ofrimin të këtij shërbimi publik në komunitetet lokale.

SHAV ka prezantuar bashkitë e vendit me gjetjet dhe rekomandimet e saj mbi arsimin parashkollor bazuar në draft strategjinë e arsimit kombëtar 2021-2026. Këto gjetje janë paraqitur për diskutim përfaqësuesve politik dhe specialistë të fushës në pushtetin lokal.

Në fokus të këtyre takimeve kanë qenë diskutimet mbi përmirësimin e këtij funksioni duke sjellë rekomandime konkrete si në drejtim të propozimeve ligjore ashtu dhe në përmirësimin e infrastrukturës në arsimin parashkollor.



Disa prej rekomandimeve përfshijnë çështje të rëndësishme si:

- Arsimi parashkollor të trajtohet si një rubrikë e veçantë në strategjinë e arsimit ku të ndahen më specifikisht detyrat dhe kompetencat institucionale.
- Rekomandimet e nxjerra do të diskutohen në takimet konsultuese me Ministrinë e Arsimit.
- Rekomandime dhe propozime në kuadër të konsultimeve edhe me institucionet e tjera.

Ky projekt është mbështetur nga projekti Bashki të Forta, financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, zbatuar në Shqipëri nga Helvetas.

Projekte dhe Aktivitete

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR: KONGRESI I AUTORITETEVE LOKALE



Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Komisionit Europian miratoi Raportin e Komitetit të Monitorimit për Shqipërinë. Në dokumentin e prezantuar nga raportuesit për vendin tonë u vlerësua progresi i bërë në drejtim të decentralizimit, demokracisë lokale, si dhe ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve në drejtim të forcimit të qeverisjes vendore.

Gjatë sesionit të 41 të Kongresit fjalën në emër të Republikës së Shqipërisë e mbajti Zëvendësministria e Brendshme, Romina Kuko, e cila adresoi në Kongres zhvillimet më të fundit të agjendës së decentralizimit në Shqipëri, fjalë e cila u mirëprit nga raportuesit, por dhe përfaqësues të vendeve anëtare të Këshillit të Europës të cilët komentuan arritjet e Shqipërisë në këtë drejtim, veçanërisht në përballimin me sukses të dy krizave të njëpasnjëshme si tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe pandemisë Covid-19.



TURIZMI DHE KULTURA

Pasuritë natyrore dhe promovimi i tyre janë një mundësi e shkëlqyer për zhvillimin e kapaciteteve turistike dhe ekonomike në Shqipëri. Për fatin tonë të madh, Shqipëria gëzon një potencial të lartë zhvillimi të turizmit duke ofruar mundësi për tërheqjen e vizitorëve në të gjitha stinët e vitit dhe në çdo qytet/fshat të saj.

Prej dy vitesh SHAV po zbaton në Shqipëri projektin për zhvillimin e sektorit të turizmit malor dhe të kulturës ADRION, Rrjetit Adriatiko-Jonian i Fshatrave Autentikë. Ky projekt synon mbrojtjen dhe promovimin e fshatrave autentikë shqiptar, të cilat shpesh ndodhen në vende jashtëzakonisht të bukura dhe që kanë një potencial të lartë zhvillimi.

Projekti ka krijuar rrjetin transnacional të "fshatrave autentike" të ADRION përgjatë pellgjeve ujëmbledhës, liqeneve, territoreve kodrinore e malore dhe zonave rurale e



ato periferike, i cili po mundëson administrimin me efikasitet të procedurave ligjore, administrative dhe teknike, të cilat sigurojnë mbrojtjen dhe promovimin e pasurive natyrore në Shqipëri.

Aktualisht, kjo nismë po zhvillohet si projekt pilot në Bashkinë Mirëditë, Bashkinë Klos dhe Bashkinë Mat, për të asistuar në promovimin dhe zhvillimin e fshatrave autentikë të këtyre zonave. Në këtë kuadër SHAV ka organizuar forume të dedikuara me bashkitë përkatëse për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore për hartimin e planeve të zhvillimit rajonal të tyre, sikurse ka mbështetur organizimin e disa aktiviteteve promovuese dhe mundësinë e materialeve bazë si sinjalistika rrugore për shtigjet e zonave të thella turistike dhe kulturore.

WORKSHOPE DHE TRAJNIME



Zhvillimi i kapaciteteve në qeverisjen vendore dhe fuqizimi i administratës lokale është një prej objektivave kryesorë të SHAV në kuadër të përmirësimit të funksioneve publike dhe efikasitetit të administratës në nivel vendor.

Gjatë vitit 2021-2022, Shoqata për Autonomi Vendore ka zhvilluar një sërë workshope dhe trajnimesh me përfaqësues të bashkive dhe organizatave lokale të shoqërisë civile ku në fokus kryesor ka qenë performanca vjetore e bashkive, funksionet e deleguara, strategjitë e komunikimit dhe rritja e kapaciteteve në menaxhimin e sfidave në arsimin parashkollor dhe krizat nga emergjencat civile.



Projekti SoRi II

PROJEKTI SORI II FOKUSOHET NË RRIJTJEN E KAPACITETETEVE TË QEVERISJES VENDORE, KOMBËTARE SI DHE NË AKTORËT JOQEVERITAR, DETYRA E TË CILËVE ËSHTË TË SIGUROJNË TË DREJTAT EKONOMIKE SOCIALE DHE KULTURORE (ESC RIGHTS).

Ky projekt është i bazuar në Agjendën 2030, si dhe në parimin “Askush mos të ngelet pas” (LNOB), i cili i mundëson aktorëve përgjegjës identifikimin, zhvillimin dhe zbatimin e strategjive për sigurimin e të drejtave ESC për grupet e marginalizuara.

SoRi II synon shkëmbimin e përvojave të pushtetit lokal në nivel kombëtar dhe rajonal me qëllim sigurimin e këtyre të drejtave për grupet e marginalizuara dhe ato vulnerabël.

Programi është një projekt i mbështetur financiarisht nga GIZ. Në nivel rajonal ai implementohet nga NALAS, ndërkohë që SHAV asiston projektin në nivel lokal.



BE për Bashkitë

“BE PËR BASHKITË” ËSHTË NJË PROJEKT QË KA PRIORITET MBËSHTETJEN E PROCESIVE STRATEGJIKE, TË CILAT DO T’IU MUNDËSOJNË AKTORËVE TË QEVERISJES LOKALE TË MOBILIZOJNË BURIMET PËR TË ZBATUAR PLANET DHE STRATEGJITË E TYRE.

BE për Bashkitë do të ndihmojë në krijimin e një praktike më të mirë për qeverisjen vendore dhe qytetarët se si duhet të përcaktohen, konsultohen dhe zbatohen përparësitë e zhvillimit të komuniteteve lokale dhe roli i drejtpërdrejtë që BE mund të ketë në përmirësimin e qeverisjes dhe cilësinë e jetës së qytetarëve. Përmes mbështetjes së bashkive në Shqipëri, projekti do të ndikojë në zhvillimin dhe rritjen e kontributit të tyre në procesin e integrimit të vendit në Bashkimin Evropian.

vendore, përmirësimin e cilësisë dhe aksesit në shërbimet vendore si dhe zhvillimin socio-ekonomik të bashkive, duke i përafuar ato me standardet evropiane.

Projekti “BE për Bashkitë” është një bashkëpunim midis NALAS si partner kryesor dhe Shoqatës për Autonomi Vendore, Co-PLAN Institute for Habitat Development, #ECOPartners for Sustainable Development dhe Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, me një financim të Bashkimit Evropian.

SHAV po asiston këtë projekt në komunikimin e thirrjeve për aplikime në skemën e granteve për 61 bashkitë e vendit. Këto thirrje do të mbështesin rehabilitimin dhe modernizmin e infrastrukturës



PUBLIKIME



RAPORTI I RENTËS

Shoqata për Autonomi Vendore dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë kanë bashkuar përpjekjet e tyre lobuese për të sjellë një ndryshim të përqindjes së rentës në favor të bashkive dhe në funksion të rritjes së standardit të shërbimeve qytetare. Një nisëm që vjen në kuadër të projektit 'Dialog për zhvillim politikash gjithëpërfshirëse në Shqipëri (ideAL)' implementuar nga Co-PLAN Instituti për Habitat dhe Zhvillim në bashkëpunim me Qendrën Evropiane të Politikave (Bruksel) dhe me mbështetjen financiare të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Raportin e plotë mund ta gjeni në lidhjen: https://www.co-plan.org/wp-content/uploads/2022/04/Renta4Bashkine_materiali.pdf



RAPORTI I PERFORMANCES SE BASHKIVE

Shoqata për Autonomië Vendore (SHAV), me mbështetje të projektit Bashki të Forta (BtF), për të plotësuar kuadrin e zbatimit të reformës së decentralizimit dhe qeverisjes vendore për vitin 2020 ndërmorri iniciativën e hartimit të një raporti studimor (sintezë) mbi performancën e bashkive në zbatim të buxhetit për vitin 2020 për programet buxhetore të NJVV. Studimi u krye në periudhën Korrik - Nëntor 2021.


Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një model raportimi koherent lidhur me përdorimin e fondeve publike nga njësitë e vetqeverisjes vendore, menaxhimin dhe zbatimin

e tyre në funksion të realizimit të shërbimeve për qytetarët, duke identifikuar hap pas hapi problematika dhe aspekte të tjera të cilat kanë për qëllim përmirësimin e metodologjisë dhe efikasitetit menaxherial dhe politikbërës në nivel vendor dhe qendror, duke mirëinformuar dhe përfshirë gjithashtu aktorët e tjerë institucional dhe komunitetin në këtë proces.

Raporti i plotë gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Shoqatës: www.shav.al



ANËTARËT



PARTNERËT

Shoqata për Autonomi Vendore, ka për qëllim të llojë e të jetë një zë i fuqishëm në bazë të politikave e të vizionit të cilat janë paraqitur në statut, për të mbrojtur e monitoruar interesat e anëtarësisë. Ndaj për ne partneriteti dhe bashkëpunimi me shoqatat homologe ndërkombëtare në përfitim të eksperiencave më të mira europiane dhe rajonale është një domosdoshmëri. Sot Shoqata operon në partneritet të ngushtë me rrjetet më të rëndësishme të shoqatave lokale Europiane dhe JugLindore dhe është një anëtare me të drejta të plota në European Association for Local Democracy.



Bashkë për më shumë zhvillim të qëndrueshëm lokal

—

Together for more
local sustainable development



Na vizitoni në: www.shav.al



SHOQATA
PËR AUTONOMINË
VENDORE